

BREAKING NEWS

x

NJE HUMBJE E MADHE! NE LUFTE QE PREJ 22 DHJETORIT ME KORONAVIRUSIN, NDER...

AKTUALITET

Rikthehen maskat në Dibër, grabitën 3 milionë lekë nën kërcënimin e armës, tre në pranga e një në kërkim

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
3 NËNTOR 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Një familje në fshatin Grykë Nokë të Dibrës ka rënë pre e grabitjes mëngjesin e djeshëm. Katër të rinjtë nga Kukësi e Dibra, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë terrorizuar anëtarët e familjes së shtetasit me inicialet I. H.. Të maskuar dhe me kallashnikov në dorë katër grabitësit kanë hyrë në banesën e shtetasit të lartpërmendur dhe nën kërcënimin e armës duke dhunuar dhe kërcënuar të zotët e

shtëpisë, kanë arritur të marrin një shumë parash. Kanë qenë banorë të zonës ata të cilët, pasi kanë dëgjuar të bërtiturat e fqinjëve të tyre kanë lajmëruar policinë, e cila ka shkuar drejt vendit të ngjarjes. Autorët pasi kanë marrë shumën e parave kanë dalë me shpejtësi nga aty, por policia është vënë në ndjekje. Dy orë pas ndjekjes policia ka arritur të bëjë të mundur arrestimin e Mensur dhe Diamant Matmuja, dy 26-vjeçarë me lidhje gjaku me njëri-tjetrin, banues në Kukës. Dy bashkëpunëtorët u shpallën në kërkim, pasi arritën t'i shpëtojnë policisë. Por policia vazhdoi operacionin dhe në mesditë arrestoi autorin e tretë, shtetasin me inicialet M. K. 25 vjeç. I riu u arrestua disa orë më pas në Bathore. Ndërkohë i vetmi person në kërkim është shtetasi me inicialet F. H., 20 vjeç, i cili ka mundur të largohet duke marrë me vete edhe shumën e parave të vjedhura. Sipas policisë ata morën 300.000 lekë dhe u larguan nga banesa me një makinë, të cilën e braktisën në malin Shumbat, kur kuptuan që ishin në ndjekje. Policia e Dibrës thotë se vijon krehja e zonës për kapjen e personit tjetër të shpallur në kërkim dhe të gjetjes së armës që dyshohet se autorët e kanë hedhur porsa kanë parë që po ndiqeshin.

Operacioni “Shumbati”

Policia e Dibrës ndërmori një operacion mëngjesin e djeshëm të koduar me emrin “Shumbati”, duke bërë të mundur zbardhjen e një vjedhjeje me armë në një banesë të një shume të konsiderueshme parash. Pas disa orë ndjekjeje dhe mbajtje nën rrethim, tre nga autorët ranë në pranga, ndërsa një tjetër u shpall në kërkim. Policia e Dibrës pas marrjes së informacionit se disa persona, nën kërcënimin e armës ishin futur në një banesë në fshatin Grykë Nokë dhe nën kërcënimin e armës kishin marrë një shumë parash ka shkuar në vendngjarje dhe është vënë në ndjekje të autorëve. Autorët në momentin që kanë konstatuar se po ndiqeshin nga policia kanë braktisur mjetin e tyre duke u fshehur në malin e fshatit Shumbat. Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Dibër në bashkëpunim dhe me agjentët e Hetimit të

Krimet në DVP, kanë rrethuar autorët në një perimetër të gjerë dhe kanë vijuar ndjekjen dhe krehjen e zonës për të bërë të mundur kapjen e tyre. Pas disa orë ndjekje dhe mbajtje nën rrethim është bërë e mundur kapja dhe arrestimi i shtetasve Mensur Matmuja dhe Diamant Matmuja, të dy nga Kukësi, kushërinj me njëri-tjetrin. Ndërsa, fillimisht dy autorët e tjerë mundën të arratiseshin dhe ti humbnin gjurmët policisë. Por kjo ka zgjatur vetëm disa orë për 25-vjeçarën me inicialet M. K., i cili është arrestuar mesditën e djeshme disa orë pas ngjarjes në kryeqytet. Ai u arrestua nga blutë e Tiranës në zonën e Bathores. Për grabitjen e mëngjesit të djeshëm i vetmi person i shpallur në kërkim është 20-vjeçari me inicialet F. H., 20 vjeç, banues në Kukës. Ai ka mundur të largohet dhe ka marrë me vete edhe shumën e parave të vjedhura. Po vijon puna për kapjen e tij. Këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin në fshatin Grykë Nokë, Dibër, dyshohet se nën kërcënimin e një arme, kanë vjedhur në banesën e shtetasit me inicialet I. H., shumën prej 300.000 lekë dhe më pas janë larguar me një automjet tip "Opel". Vijon krehja e zonës për kapjen e dy personave të shpallur në kërkim dhe të gjetjes së armës që dyshohet se autorët e kanë hedhur porsa kanë parë që ndiqeshin nga policia. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar mjeti i përdorur nga autorët. Materialet hetimore do ti referohen Prokurorisë Dibër për veprën penale "Vjedhje me armë", e kryer në bashkëpunim./ **Elvis MYRTA**

YOU MAY LIKE

by mgid



Učitelj iz Beograd postao milioner što je saznao za ovu metodu

BITCOIN ERA